

Hyrje¹

Ky numër i *Studimeve për artin* shqyrton temën e revizionizmit, kuptuar njëkohësisht si një dukuri historike, për aq sa lufta kundër të ashtuquajturit “revizionizëm modern” (fillimisht sovjetik por më pas edhe kinez) luajti një rol vendimtar në rrugën e ndjekur nga Partia e Punës së Shqipërisë nga fillimi i viteve 1960 deri në vdekjen e Enver Hoxhës në vitin 1985, për të mos thënë deri në rënien e vetë sistemit socialist në fillim të viteve 1990 dhe, në një kuptim më të gjerë, si një përpjekje për të rishkruar historinë, rast në të cilin revizionizmi përfaqëson një shtysë që përkufizon periudhën post-socialiste po aq sa periudhën socialiste, duke u mundësuar kontribuuesve të këtij numri të hetojnë vijimësitë dhe thyerjet midis periudhave socialiste dhe post-socialiste dhe, gjithashtu, të zbulojnë se çfarë mund të na tregojnë ato për momentin bashkëkohor.

Numri hapet me artikullin e shkruar nga Raino Isto, “‘Një valle e lashtë që vazhdon të kërcëhet’, Kultura popullore, nacionalizmi dhe arti socialist në Shqipëri pas Plenumit të Katërt të vitit 1973”, i cili është një pjesë shoqëruese e artikullit “‘Kjo ekspozitë, që do të hyjë në historinë e pikturës sonë’: Ekspozitat e artit në Shqipëri rreth vitit 1972 dhe pranvera e premtuar”, botuar në numrin e mëparshëm të revistës, që shqyrtoi temën e fillimeve. Atje, Isto vërejti se si Revolucioni Ideologjik dhe Kulturor krijoi kushtet për një angazhim domethënës, ndonëse jetëshkurtër, me stilet moderniste në pikturën shqiptare të

¹ Përkthyer në gjuhën shqipe nga Durim Taçi.

Hyrje

fundit të viteve '60 dhe fillimit të viteve '70, si pjesë e një përpjekjeje për të zgjeruar fushën e realizmit socialist shqiptar në valën e kthesës revizioniste të Bashkimit Sovjetik në fillim të viteve 1960. Këtu, Isto tërheq vëmendjen tek epoka pas-revolucionare, përkatësisht periudha pas famëkeqit Plenumi i Katërt i PPSH-së në qershor të vitit 1973, kur theksi u zhvendos drejt një angazhimi me kulturën popullore dhe folklorin. Isto argumenton se kjo kthesë revizioniste në dukje, përfaqësonte në të vërtetë një tërheqje strategjike përballë mundësive të pakësuara revolucionare në shkallë globale, ndërsa përpiquej të krijonte një kornizë alternative për një art dhe kulturë revolucionare që angazhohej me potencialin emancipues të shpërbërjes së rendit kolonial në Jugun Global.

Kjo pasohet nga artikulli i Dorina Pllumbit, “Fasada urbane, hije politike: Kthesa nacionaliste e Tiranës në arkitekturë dhe nëntekstet e saj”, në të cilin ajo argumenton se aktualisht po përjetojmë një kthesë të dytë nacionaliste në arkitekturën shqiptare të pasluftës pas asaj të viteve '70. Në diskutimin e saj, Pllumbi përqendrohet në shpërfaqjen konkrete të këtyre kthesave nacionaliste, përmes analizës së ndërtesave emblematike, si dhe në motivet më të thella që qëndrojnë pas tyre, duke analizuar kontekstin më të gjerë në të cilin ato u shfaqën. Ajo që del ngadalë në pah, është se vazhdimësitë midis periudhave socialiste dhe post-socialiste, si riciklimi i ligjërimeve orientaliste (përmes figurës së Skënderbeut) ose instrumentalizimi politik i artistëve dhe (në këtë rast) arkitektëve, zbulojnë thyerje të thella. Ndërkohë që kthesa nacionaliste e viteve '70 kishte si qëllim, të paktën në parim, ruajtjen e “pastërtisë” së projektit socialist shqiptar duke i rezistuar imperializmave të ShBA-së dhe të Bashkimit Sovjetik njëherazi, prirja nacionaliste e kohëve të fundit është një përpjekje për krijimin e një marke të kombit që përkon me rrënjosjen e shtetit neoliberal në Shqipëri dhe zbatimin e projekteve neokoloniale në Ballkan me përgjithësisht, të përkeqësuar nga kthesa djathtiste e politikës evropiane në dekadën e fundit.

Pika e fundit është përpunuar më tej nga kontributi i Tong Lam,

Hyrje

“Ekranet e magjepsjes: Nga kinemaja shëtitëse e popullit te konsumi digjital”, këtë herë përmes thjerrës së kinemasë shëtitëse në Kinë. Lam argumenton se ringjallja e kinemasë shëtitëse të sponsorizuar nga shteti në Kinën bashkëkohore, është përdorur, ndër të tjera, për të formësuar një histori revizioniste që përpiket të projektojë një vijimësi të pandërprerë midis periudhave revolucionare dhe pas-revolucionare të vendit, duke ushqyer një ligjërim nacionalist që ngre në qiell “narrativat e triumfit kombëtar dhe udhëheqjen heroike të partisë-shtet” (f. 168). Lam sugjeron se përpjekje të tilla për të errësuar thyerjet midis epokave socialiste dhe post-socialiste dhe rikthimi tek nacionalizmi, sinjalizojnë dështimin e epokës së pas-reformës dhe, veçanërisht, të sistemit shtetëror kapitalist autoritar të vendosur gjatë asaj periudhe, për të përmbushur premtimin e saj, gjë që është bërë veçanërisht e dukshme në tendencat reaksionare të dekadës së fundit. Në të vërtetë, analiza e kushteve të prodhimit, shpërndarjes dhe shikimit të kinemasë shëtitëse të sponsorizuar nga shteti në periudhën revolucionare kundrejt periudhës bashkëkohore, si dhe të vetë filmave që shfaqen, zbulon një zhvendosje të qartë drejt një logjike neoliberalë.

Thyerjet dhe, më saktësisht, gjurmët e lëna nga thyerjet e njëpasnjëshme mbi mjedisin natyror dhe peizazhet post-industriale të Shqipërisë, janë subjekti i kontributit të dhënë nga Dimitra Gkitsa, “Çështje të kujtesës: Vendet e braktisura post-socialiste si materiale dëshmie”. Gkitsa shqyrton se si artistët bashkëkohorë shqiptarë i kanë përdorur këto vende ku koha grumbullohet vazhdimisht dhe kohësitë e shumta mbivendosen, për të ndërtuar një kritikë të koncepteve lineare të historisë, që përfaqëson ndoshta një nga vazhdimësitë më problematike midis periudhave socialiste dhe post-socialiste. Siç vëren Gkitsa, ideja e progresit dhe, veçanërisht, shfrytëzimi dhe nënshtrimi i natyrës në emër të tij, kishte një rëndësi të posaçme si në periudhën socialiste ashtu edhe në periudhën post-socialiste, megjithëse në mënyra dhe për arsye të ndryshme. Ashtu si pjesa tjetër e kontribuuesve të këtij numri, Gkitsa thekson se kuptimi i këtyre ndryshimeve është

Hyrje

thelbësor dhe se kujtesa kolektive e socializmit mund të ndihmojë ende në formësimin e një kritike efektive të së tashmes neoliberales.

Ky numër përfundon me recensionin e Ana Grgić mbi monografinë e Bruce Williams, *Kinemaja shqiptare përmes rënies së komunizmit: ekranet e argjendta dhe flamujt e kuq* (Amsterdam University Press, 2023) dhe vëzhgimin e Vincent W.J. van Gerven Oei mbi librin e Nicholas Tochka-s, *Projekt Jon* (Bloomsbury Academic, 2024). Numri i ardhshëm i *Studimeve për artin* do të fokusohet te tema e përfundimeve, përqendruar veçanërisht në dekadën e fundit të sundimit komunist në Shqipëri. Qëllimi i numrit do të jetë identifikimi i produkteve kulturore që arritën të parashikojnë, në mënyrë kritike, rënien e shtetit socialist dhe të asaj që erdhi pas tij.

Jonida Gashi
(Kryeredaktore)